



**BASHKIA
TIRANË**

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 43, datë 05.04.2017

PËR

“MIRATIMIN E HAPJES SË NJË THERTOREJE PUBLIKE NË VARËSI TË AGJENCISË SË MBROJTJES SË KONSUMATORIT PRANË BASHKISË SË TIRANËS PËR GARANTIMIN DHE RITJEN E SIGURISË USHQIMORE”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “b”, pika 1/1.4, shkronja “a”, nenit 35, pika 5, shkronja “a”, nenit 54, shkronjat “f” dhe “k”, nenit 55 dhe 64 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”; Ligjin nr.44/2015, 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); nenin 54 të Ligjit Nr.10 465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin Nr.230, datë 20.03.2013 të Këshillit të Ministrave, për “Funksionet dhe detyrat e shërbimit veterinar në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, nenet 1, 4 dhe 7 të Aktit Normativ Nr. 4, datë 16.08.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”, miratuar me Ligjin nr.87/2012; Vendimin nr. 59, datë 30.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të ndryshuar, Vendimin e Këshilli Bashkiak nr. 84, datë 29.12.2016 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë ngritjen e thertores publike nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, në vijim Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, për ritjen dhe garantimin e sigurisë ushqimore të konsumatorit të qytetit të Tiranës.
2. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë e Mbrojtjes së Konsumatorit për vitin 2017.

3. Deri në krijimin e kushteve dhe ambienteve nga Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, autorizohet kjo agjenci të identifikojë dhe të marrë në përdorim një ambient ekzistuese që plotëson kushtet dhe standardet për një thertore publike.
4. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit pranë Bashkisë së Tiranës, që të ndjekë procedurat e nevojshme për gjetjen e ambientit të përshtatshëm në mbështetje të pikës 3 të këtij vendimi.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë së Tiranës, për ndjekjen e procedurave dhe vjeljen e detyrimeve tarifore në thertoren publike, në varësi të Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit.
6. Të miratojë tarifat për shërbimin e therjes sipas Aneksit nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Bashkia Tiranë dhe Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit, që brenda strukturës së saj që ka në dispozicion aktualisht, të marrë masat për plotësimin me punonjës të thertoresh publike.
8. Ngarkohet Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Aneks Nr.1: Tarifat për shërbimet e ofruara në thertoren publike

Lekë / krerë

Kategoritë gjedh / të imta	Tarifa me transport	Tarifa pa transport
Lopë	1 100	1 000
Viç	1 100	1 000
Qingj	250	150